



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Rregulla ZRRE/Nr. 02/2017**

## **RREGULLA PËR INFORMATAT KONFIDENCIALE**

**Prishtinë, 16 mars 2017**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7, Nenin 12 paragrafin 2, Nenin 26 dhe Nenin 58 paragrafin 2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084) në seancën e mbajtur më 16 mars 2017 miratoi:

## **RREGULLËN PËR INFORMATAT KONFIDENCIALE**

### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni1

##### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulle është që të përcaktojë se cili material i veçantë konsiderohet informatë konfidenciale (fshehtë) si dhe procedurat për përcaktimin dhe qasjen në informatën e tillë konfidenciale.

Neni2

##### **Fushëveprimi**

1. Kjo rregull zbatohet për të gjitha dokumentet që mbahen apo pranohen nga Rregullatori.
2. Sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori ka të drejtë të kërkojë nga secila ndërmarrje për energji apo autoritet publik çdo informatë, të dhënë dhe dokument, përfshirë llogaritë dhe të gjitha informatat tjera financiare dhe të kontabilitetit, përfshirë edhe informacionet konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Për të ushtruar këtë të drejtë Rregullatori do të:
  - 3.1. sigurojë transparencë duke siguruar që i Licencuari, konsumatorët dhe publiku të kenë qasje të hapur në informata;
  - 3.2. sigurojë që të gjitha informatat jo-konfidenciale janë në dispozicion të publikut nën kushte të njëjta dhe lehtë për t'iu qasur atyre;
  - 3.3. mbrojë interesat konkurruese të të licencuarve, apo cilësdo palë, nga zbulimi i paautorizuar i informatave të ndjeshme komerciale; dhe
  - 3.4. sigurojë se ka krijuar nivel të mjaftueshëm të besimit dhe njohurisë për pjesëmarrësit në treg.

4. Të gjitha informatat e pranuar nga Rregullatori në përmbushjen e aktiviteteve të saja rregullative do të konsiderohen si informata publike përveç nëse janë të përcaktuara si informata konfidenciale sipas kësaj Rregulle dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

### Neni 3

#### **Përkufizime**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1. **Aplikant** – çdo palë e cila ka aplikuar në Rregullator për marrjen e licencës për ushtrimin e aktivitetit të energjisë, marrjen e autorizimit, zgjidhjen e kontesteve, aprovimin e kodeve, tarifave dhe çmimeve, marrjen e Certifikatës së Origjinës apo që ka kërkuar nga Rregullatori të kryej çfarëdo aktiviteti tjetër në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
  - 1.2. **Informatë konfidenciale** – të dhëna, dokumente apo informacione të tjera, komerciale apo teknike, që kanë të bëjnë me dizajnin, rehabilitimin, sigurinë, veprimin, mirëmbajtjen dhe financimin e veprimeve energjetike apo aktivitete që nuk janë më në domenin publik dhe që shpallja e tyre mund t'i vë në rrezik interesat komerciale të aplikuesve apo te të licencuarve;
  - 1.3. **Palë e interesuar** – çdo palë që mund të ketë ndonjë interes në çfarëdo informate të pranuar nga Rregullatori.
  - 1.4. **Kërkues i dokumentit** – person fizik apo juridik që mund të ketë ndonjë interes, pa diskriminim në çfarëdo lloj baze, në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me këtë rregull, dhe ndonjë ligj tjetër në fuqi;
  - 1.4. **Informatë publike** – informata të mbledhura, grumbulluara apo të mbajtura nga Rregullatori e të cilat nuk konsiderohen konfidenciale;
  - 1.5. **Zyra e Rregullatorit për Energji** – (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) – agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
  - 1.6. **Bord** – Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, siç është përcaktuar në Kapitullin II të ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
2. Shprehjet e përdorur në këtë Rregull, kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Ngrohjen Qendrore, Ligjin për Gazin Natyror, Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

## **KREU II**

### **INFORMATATA KONFIDENCIALE**

Neni 4

#### **Kriteret për përcaktimin e informatave konfidenciale**

1. Informata do të konsiderohet konfidenciale nëse ajo përmbush kriteret si në vijim:
  - 1.1. informata të jetë e ndjeshme nga ana komerciale;
  - 1.2. zbulimi i informatës do të cenojë interesat konkurruese të Licencuarit apo palëve tjera që kërkojnë nga Rregullatori që informata të trajtohet konfidenciale;
  - 1.3. pala që ka kërkuar që informata të trajtohet si konfidenciale, ka bërë përpjekje të arsyeshme për të mbajtur fshehtësinë apo konfidencialitetin e informatës; dhe,
  - 1.4. dëmtimi i mundshëm që rrjedh nga zbulimi i informatës do të jetë më i rëndë se interesi publik për zbulimin e saj.
2. Shtojca 1 paraqet udhëzime për llojet e informatave që mund të konsiderohen konfidenciale, nëse kriteret nga paragrafi 1 i këtij Neni janë përmbushur.

## **KREU III**

### **TRAJTIMI I INFORMATAVE QË KONSIDEROHEN KONFIDENCIALE**

Neni 5

#### **Dorëzimi i informatave që konsiderohen konfidenciale**

1. Informatat e pranuar nga Rregullatori konsiderohen të jenë publike dhe i nënshtrohen qasjes së plotë për të gjitha palët e interesuara , përveç nëse Bordi përcakton se një informatë e tillë është konfidenciale sipas dispozitave të kësaj Rregulle dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.
2. Çdo aplikant, i licencuar apo palë e tretë që kërkon nga Rregullatori që një informatë e caktuar të trajtohet si informatë konfidenciale, sipas shtojces 3 të kësaj rregulle, duhet ta shënjojë atë si “Informatë Konfidenciale” dhe Rregullatori do ta trajtojë atë si të tillë, deri në përcaktimin nga Bordi me vendim të veçantë për pranimin ose jo të konfidencialitetit të asaj informate.
3. Nëse kërkohet nga Rregullatori që informata e tillë të bëhet publike, Bordi do të vlerësojë nëse zbulimi i informatës së tillë mund ta dëmtojë palën apo të tjerët nën kushte të caktuara dhe për këtë mbajtja e konfidencialitetit është e domosdoshme.
4. Informata e shënjuar nga Pala si konfidenciale, duhet t’i përmbush kriteret nga Neni 4 paragrafi 1 i kësaj rregulle.
5. Për Informatat nga paragrafi 4 i këtij Neni pala mund të kërkojë nga Rregullatori që me shkrim informatën e tillë ta përcaktojë si konfidenciale. Kërkesa duhet të përmbajë arsyetim për një

përcaktim të tillë. Rregullatori do ta shqyrtojë kërkesën dhe do ta bëjë përcaktimin e informatës së tillë, në pajtim me Nenin 7 të kësaj rregulle.

#### Neni 6

#### **Rishqyrtimi nga Rregullatori**

1. Anëtarët e personelit të Rregullatorit që pranojnë dokumente të cilat përmbajnë informata që janë të shënuara si “Informatë konfidenciale” ato informata do të trajtohen si të tilla.
2. Pas pranimit të kërkesës sipas Nenit 5, paragrafi 5 të kësaj rregulle, Rregullatori do ta konsiderojë informatën si konfidenciale.
3. Informata e cila është kërkuar të trajtohet si konfidenciale, do të trajtohet e tillë nga të gjithë punonjësit dhe Bordi i Rregullatorit deri në momentin kur ndonjë palë e tretë do të kërkojë qasje në informatën e tillë.
4. Pas kërkesës së ndonjë pale të tretë për qasje në dokumente sipas paragrafit 2 të këtij neni, Bordi do të merr vendim nëse dokumenti konsiderohet konfidencial ose jo.
5. Dokumentet do të ruhen si konfidenciale dhe do të shënjoen nga ZRRE si të tilla, sipas Rregullës për Regjistrat Publik.

#### Neni 7

#### **Përcaktimi i konfidencialitetit**

1. Informata e shënuar si konfidenciale nuk do të zbulohet gjersa Bordi nuk e ka bërë përcaktimin e konfidencialitetit.
2. Nëse Bordi përcakton se informata e përcaktuar nuk i përmbush kriteret për konfidencialitet, një informatë e tillë mund të vihet në dispozicion të publikut, në pajtim me procedurat e parapara me rregullat dhe me ligjet në fuqi.
3. Nëse Bordi e përcakton se informata e caktuar i përmbush kriteret për konfidencialitet do ta trajtojë atë si konfidenciale, dhe do konstatoj dhe arsyetoj këtë me vendim.
4. Për të penguar qasjen e paautorizuar në informatat konfidenciale, ato duhet të mbahen, ruhen dhe menaxhohen në përputhje me këtë rregull dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

### **KREU IV**

#### **QASJA NË DOKUMENTE**

#### Neni 8

#### **E drejta për qasje në dokumente**

1. Çdo kërkuar i dokumentit ka të drejtë qasjeje në dokumente të Rregullatorit, në pajtim me këtë rregull dhe Ligjin për qasje në dokumentet publike.

2. Kërkuesi i dokumentit nuk është i obliguar të japë arsye për qasje në dokumente të Rregullatorit.
3. Nëse kërkesa nuk është sa duhet e saktë, Rregullatori kërkon nga kërkuesi që ta qartësojë kërkesën dhe i ndihmon kërkuesit që ta bëjë këtë.
4. Dokumentet janë të hapura për publikun në bazë të kërkesës së drejtpërdrejt, në bazë të kërkesës së bërë me shkrim ose në formë elektronike, me përjashtim të informacioneve konfidenciale, të cilat do të trajtohen në pajtim me këtë rregull dhe ligjet në fuqi.
5. Kërkuesi nuk mund të përdor dokumentet e pranuar nga Rregullatori për qëllime denigrimi, propagandistike, komerciale apo qëllime tjera.

## **KREU V**

### **REFUZIMET E QASJES NË DOKUMENTE**

#### **Neni 9**

#### **Përjashtimet e së drejtës së qasjes në dokumente**

1. Rregullatori do të refuzojë qasjen në dokumente nëse zbulimi i tyre do të cenojë mbrojtjen e interesit publik ashtu siç përcaktohet me Nenin 12 të Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike,
2. Bordi do të mbyll pjesën e çfarëdo seance publike, për të gjitha palët, kur materiali i cili konsiderohet të jetë konfidencial është duke u shqyrtuar, përveç atyre personave të cilët janë vlerësuar nga Bordi që të kenë qasje në informatën konfidenciale.
3. Nëse informata është përcaktuar si konfidenciale, secila palë përfshirë edhe anëtarët e personelit të Rregullatorit duhet t'i përmbahen kushteve të qasjes në informatën konfidenciale siç është përcaktuar nga Bordi.
4. Nëse kërkesa për qasje në informatë konfidenciale është refuzuar apo pranuar, Bordi do t'i japë arsyet për refuzim në mënyrë që të mos dëmtohen interesat e mbrojtura.
5. Informata e përcaktuar nga Bordi si konfidenciale mund të zbulohet para organeve gjyqësore dhe publike sipas procedurave të vendosura në rregullat e Rregullatorit dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
6. Përfaqësuesit e autorizuar të palëve të interesuara të cilët marrin pjesë në Seancat e Bordit mund të kërkojnë nga Bordi që të kenë qasje gjatë shqyrtimit të informatave konfidenciale. Bordi do të lejojë qasje të tillë në informata konfidenciale nën kushtet si në vijim:
  - 6.1. pasi të konkludoj se pala e interesuar kërkon qasje në mënyrë që të sjell prova adekuate në një çështje për të cilën informata është e nevojshme; dhe
  - 6.2. pas dorëzimit të deklaratës me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar që informata nuk do të zbulohet para individëve tjerë që më parë nuk u është autorizuar qasja apo para publikut të përgjithshëm dhe se çfarëdo shkelje e marrëveshjes do t'i nënshtrohet sanksioneve.

## Neni 10

### **Obligimet e anëtarëve të bordit dhe personelit të rregullatorit**

1. Çdo Anëtarë i Bordit dhe personelit të cilët gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare, mund të kenë qasje në informata konfidenciale do të ketë obligim që të mos e zbulojnë para asnjë pale tjetër asnjë informatë konfidenciale. E njëjta zbatohet edhe për ekspertët të punësuar nga institucionet apo palët tjera të angazhuara në aktivitete rregullative, konsultime, monitorime, auditime dhe aktivitete tjera të kryera nga Rregullatori.
2. Obligimi sipas paragrafit 1 të këtij Neni është i vlefshëm në çdo kohë gjatë punësimit në Rregullator, si dhe pas skadimit të kontratës së punës me Rregullatorin. Anëtarët e Bordit dhe personeli i Rregullatorit nuk do të zbulojnë, shfrytëzojnë apo përdorin informatat e tilla për qëllime personale apo për ndonjë qëllim tjetër.
3. Përdorimi i informatave të tilla për përfitime personale financiare apo për t'i sjellë përfitim të tjerëve, jo vetëm që do të konsiderohet shkelje serioze e kontratës së punës, por edhe mund të rezultojë në iniciimin e procedurës civile apo penale.

## Neni 11

### **Zbulimi i paautorizuar i informatave konfidenciale**

1. Në rast të zbulimit të paautorizuar të informatës konfidenciale, Bordi në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat, do të shqiptojë masa administrative ose gjoba ndaj çdo anëtari të personelit për shkak të zbulimit të paautorizuar të informatës konfidenciale.
2. Nëse një ndalesë-zbulimi sipas Nenit 9 paragrafit 6 të kësaj rregulle është shkelur, Bordi do të ketë të drejtë të ndalojë pjesëmarrjen e përfaqësuesit të autorizuar në çfarëdo procesi konsultativ të Rregullatorit dhe qasje të ardhshme në çfarëdo informate konfidenciale dhe nëse është e nevojshme do të shqiptojë masa administrative ose gjoba, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
3. Informatat e klasifikuara si “konfidenciale” deklasifikohen, pesë (5) vite pas datës kur Bordi i ka përcaktuar ato si konfidenciale, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.
4. Nëse nga pala kërkohet që informatat konfidenciale duhet të mbesin të tilla edhe pas skadimit të periudhës siç është paraparë në paragrafin 3 të këtij Neni, Bordi mund të shtyjë këtë afat edhe për një periudhë tjetër kohore.

## KREU VI

### DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 12 Interpretimi

Në rast të paqartësive për dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

#### Neni 13 Ndryshimi

1. Rregullatori mban të drejtën që të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për ndryshim dhe modifikim të kësaj Rregulle, do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.


#### Neni 14 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulle shfuqizohet "Rregulla mbi Informatat Konfidenciale" (qershor 2011) e nxjerrë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185.


#### Neni 15 Hyrja në fuqi

Rregulla hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

**Bordi i Zyës së Rregullatorit për Energji :**



Krenar Bujupi, u.d kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfiqaj, anëtar



## **SHTOJCA 1**

### **Lista me disa nga informatat të cilat konsiderohen konfidenciale**

Lista nuk lë të kuptojë se vetëm ose të gjitha informatat e mëposhtme mund të cilësohen si konfidenciale:

1. informatat komerciale dhe teknike që kanë të bëjnë me dizajnin, rehabilitimin, sigurimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me financimin dhe funksionimin e sektorit të energjisë;
2. të dhënat që kanë të bëjnë me pronën intelektuale, shënimet dhe informatat, sekretet e punës, patentet, produktet e mbrojtura, e drejtat e kopjimit, planet e biznesit, marketingut dhe shërbimit, bazat e shënimeve dhe çdo shënim dhe raport financiar të papublikuar.
3. të dhënat të cilat mund të cenojnë fshehtësinë dhe integritetin e individit sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
4. të dhënat për kontabilitetin e brendshëm, planet e biznesit etj;
5. të dhënat që kanë të bëjnë me dokumentet që janë ende në fazë të hartimit të tyre;
6. të dhënat që mund të shfrytëzohen për qasje në rrjetet e kompjuterëve të kompanisë;
7. të dhënat që kanë të bëjnë me planin e aplikantit për t'iu drejtuar tregjeve të caktuara; strategjinë e aplikantit lidhur me konkurrentët e caktuar; dhe studimet e tregut të aplikantit dhe analizat, nëse ato nuk janë vënë publikisht në dispozicion;
8. pasqyrat projektuese, të dhënat e kostos, vlerësimet e projekteve, korrespondenca e projekteve e cila kërkohet të jetë konfidenciale dhe planet kapitale zhvilluese;
9. informatat të cilat drejtpërdrejt kanë të bëjnë me ofertat, propozimet apo negociatat për shitjen apo blerjen e energjisë apo shërbimeve të energjisë, zbulimi i të cilave mund të shkaktojë dëmtim të interesave konkurruese për ndërmarrjet e energjisë ose klientëve të tyre;
10. të dhënat, të cilat nëse zbulohen, do të ndikojnë në inspektimet, hetimet dhe auditimet, përveç nëse është një interes thelbësor i publikut në zbulimin e tyre;
11. komunikimet ndërmjet të të Licencuarit dhe autoriteteve të ndryshme përveç nëse interesi publik është më i rëndësishëm se arsyeja për konfidencialitet;
12. zbulimi i çfarëdo regjistri apo informate që është i ndaluar me ligjet apo rregulloret në fuqi, etj.

## SHTOJCA 2

### Mostra për Qasje në Dokumente Publike të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Datë: \_\_\_\_\_, Prishtinë

#### Formulari i Kërkesës me shkrim drejtuar Rregullatorit të Energjisë:

Për: Zyra e Rregullatorit për Energji

Z. \_\_\_\_\_

Adresa: "Rr. "Dervish Rozhaja" nr.12, Prishtinë

Nga: Z. \_\_\_\_\_, Qytetar nga \_\_\_\_\_

Kontaktet:

mob: \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_

Nr. personal: \_\_\_\_\_

Lënda: **Kërkesë për qasje në dokument zyrtar**

I/e Nderuar \_\_\_\_\_,

Bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (03/L-215), kërkojë një kopje të dokumentit

---

---

---

---

Sinqerisht (emri, mbiemri, nënshkrimi)

---

*Sipas ligjit për qasje në dokumente publike:*

*Kërkuesi i ndonjë dokumenti nuk është i obliguar që të japë arsye për të pasur qasje në dokumente.*

*Kërkuesi i ndonjë dokumenti ka të drejtë për të mbetur anonim ndaj palëve të treta.*

### **SHTOJCA 3**

## **MOSTRA E KËRKESËS PËR TRAJTIMIN E NJË INFORMATE SI KONFIDENCIALE NË ZYRËN E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**

Datë: \_\_\_\_\_, Prishtinë

### **Formulari i Kërkesës me shkrim drejtuar Rregullatorit të Energjisë:**

Për: Zyra e Rregullatorit për Energji

Z. \_\_\_\_\_

Adresa: "Rr. "Dervish Rozhaja" nr.12, Prishtinë

Nga: Z. \_\_\_\_\_, Qytetar nga \_\_\_\_\_

Kontaktet:

mob: \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_

Nr. personal: \_\_\_\_\_

Lënda: **KËRKESË PËR TRAJTIM TË NJE INFORMATE SI KONFIDENCIALE**

I/e Nderuar \_\_\_\_\_,

Bazuar në Nenin 6 të kësaj rregulle kërkojmë nga Bordi i Rregullatorit që informatat/dokumentet e bashkengjitura kësaj kërkesë të konsiderohen

konfidenciale: \_\_\_\_\_

---

---

---

Sinqerisht (emri, mbiemri, nënshkrimi)

---